

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Ligjet dhe tatimet në
Kosovë**

P4

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme

Data 13/07/2024

Pjesa A. Detyra me zgjidhje të shumëfishtë (vetëm një opsion i saktë) Nga 2 pikë secila

1. Fatura në vlerë prej 20,000.00 Euro para TVSH-së, i dedikohet shitjeve të librave shkollorë. Sa duhet të jetë vlera e TVSH-së në këtë faturë?
 - a) **1,600.00 Euro;**
 - b) 1,024.00 Euro;
 - c) 00.00 Euro;
 - d) 1,852.00 Euro.

2. Në muajin Maj 2024, kompania TECHSOLUTIONS LLC pranoi një faturë në vlerë prej 6,500 EUR për shërbime IT nga një furnitor jashtë vendit. Kompania është e detyruar të përdorë ngarkesën e kundërt për këtë faturë. Duke pasur parasysh që kompania aplikon një koeficient zbritesh prej 70%, sa do të jetë rritja e TVSH-së të llogaritur dhe rritja e TVSH-së të zbritshëm në deklaratën e TVSH-së për muajin Maj 2024?
 - a) **1,170.00 Euro rritja e TVSH-së të llogaritur dhe 819.00 Euro rritja e TVSH-së të zbritshëm;**
 - b) 1,170.00 Euro rritja e TVSH-së të llogaritur dhe 1,170.00 Euro rritja e TVSH-së të zbritshëm;
 - c) 819.00 Euro rritja e TVSH-së të llogaritur dhe 819.00 Euro rritja e TVSH-së të zbritshëm;
 - d) 0.00 Euro rritja e TVSH-së të llogaritur dhe 0.00 Euro rritja e TVSH-së të zbritshëm.

3. Arlinda Dervishi për vitin 2022 ka realizuar të ardhura bruto nga pagat prej 11,500.00 Euro. Sa janë obligimet tatimore për këtë vit pas çfarëdo zbritje të lejuar?
 - a) 972.00 Euro;
 - b) 786.00 Euro;
 - c) 930.00 Euro;
 - d) **826.10 Euro;**

4. Ermal Krasniqi për vitin 2022 ka realizuar të ardhura bruto nga pagat prej 9,000.00 Euro. Sa është shuma e kontributit pensional të detyruar i punëdhënësve dhe i të punësuarit për këtë vit?
 - a) 450.00 Euro;
 - b) 540.00 Euro;
 - c) **900.00 Euro;**
 - d) 810.00 Euro.

5. Shoqëri "TIK TOK" SH.P.K ka fitim para tatimit 200,000 EUR, sa është shuma e sponsorizimit në fushën e sporteve lejuar për këtë kompani?
- a) 20,000 Euro;
 - b) 12,000 Euro;
 - c) 6,000 Euro;**
 - d) 18,000 Euro.
6. Shoqëri "TIK TOK" SH.P.K ka fitim para tatimit 200,000 EUR. Sa është shuma e sponsorizimit në fushën e kulturës e lejuar për këtë kompani?
- a) 4,000 Euro;**
 - b) 12,000 Euro;
 - c) 6,000 Euro.
 - d) 2,000 Euro.
7. Nëse një shoqëri tregtare ka fitim para donacionit 150,000 EUR, sa është shuma e donacionit e lejuar për këtë kompani?
- a) 15,000 Euro;**
 - b) 10,000 Euro;
 - c) 12,000 Euro;
 - d) 9,000 Euro.
8. Kompania ProTech SH.P.K ka bërë riparimin e zyrave të marra me qira, vlera e këtij riparimi është 30,000 EUR. Kontrata e qirasë për përdorim të zyrave është për periudhë 15 vjeçare. Sa është shuma e lejuar e zhvlerësimit për një vit sipas Tatimit në të Ardhurat e Korporatave?
- a) 3,000.00 Euro;
 - b) 2,000.00 Euro;**
 - c) 1,500.00 Euro;
 - d) 30,000.00 Euro.

9. Kompania ServisPro B.I, e angazhuar në aktivitet shërbyes me të ardhura vjetore bruto deri në pesëdhjetë mijë euro (50,000 €), nuk është regjistruar ne te ardhurat reale. Për periudhën TM3-2022 ka faturuar shumën në vlerë prej 10,000 EUR, ndërsa ka inkasuar kesh për këtë periudhë 8,500 EUR. Sipas ligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale, cila është shuma e obligimit tatimor për këtë TM3?

- a) **765.00 Euro;**
- b) 828.00 Euro;
- c) 702.00 Euro;
- d) 234.00 EUR.

10. Kompania TechWare SH.P.K ka një aset të grupit të tretë sipas ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave. Kostoja e asetit është 60,000 Euro dhe kompania kishte politikë kontabël të zhvlerësimit për njëzet vite përdorim. Sa është ndryshimi i zhvlerësimit vjetor sipas politikës kontabël dhe sipas ligjit tatimor?

- a) 3,000 Euro më i lartë për qëllime kontabël;
- b) 3,000 Euro më i ulët për qëllime kontabël;
- c) 1,500 Euro më i ulët për qëllime tatimore;
- d) **3,000 Euro më i lartë për qëllime tatimor**

Pjesa B. Pyetjet “E saktë/ E pasaktë”

Nga 1 pikë secila

1. Shoqëri Tregtare - është term i përgjithshëm që do të thotë dhe përfshin çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë, duke përfshirë bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, ortakëritë e kufizuara, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare.

E saktë

E pasaktë

2. Sipas Ligjin në fuqi Për Shoqëritë Tregtare, zyra e regjistrimit te bizneseve duhet të mbajë kopjet origjinale në letër të të dhënave për së paku 5 vite.

E saktë

E pasaktë

3. Sipas Ligjin në fuqi “Për Shoqëritë Tregtare”, me rastin e regjistrimit fillestar, Shoqërisë Tregtare ose subjekti tjetër i përcaktuar me këtë ligj, i lëshohet Numri Unik Identifikues i cili shërben si numër për identifikimin e Shoqërisë Tregtare për qëllime të regjistrimit dhe por jo për qëllime tatimore.

E saktë

E pasaktë

4. Sipas Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, shoqëritë tregtare për qëllime të këtij Ligji klasifikohen si: mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla, ndërmarrje të mesme dhe ndërmarrje të mëdha, mbi bazën e treguesve të përcaktuar në ditën e fundit të vitit të kaluar financiar, për qëllime të përgatitjes së pasqyrave financiare për vitin aktual, sipas këtyre kritereve: 1. qarkullimi neto; 2. numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar.

E saktë

E pasaktë

5. Sipas Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, mikro-ndërmarrjet janë ndërmarrje të cilat nuk tejkalojnë kufijtë e së paku dy (2) nga tre kriteret e përcaktuara nga ky ligj. Njëri nga tre kriteret është numri mesatar i të punësuarve prej dhjetë (10).

E saktë

E pasaktë

6. Sipas Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, ndërmarrjet e vogla janë ndërmarrje të cilat nuk janë mikro-ndërmarrje, por nuk tejkalojnë më shumë se dy(2) nga tre kriteret e këtij ligji. Njeri nga tre kriteret është qarkullimi neto prej tetë milion euro (8,000,000.00 €);

E saktë

E pasaktë

7. Sipas Ligjit Për Administrimin e Procedurave Tatimore, regjistrat e lidhura me pasuritë që kërkojnë përcaktimin e bazës për trajtimin e fitimeve kapitale apo përcaktimin e fitimit me shitjen e tyre, duhet të mbahen derisa pasuritë e tilla të jenë shitur apo ekspozuar me plus gjashtë (6) vite shtesë.

E saktë

E pasaktë

8. Sipas Ligjit Për Administrimin e Procedurave Tatimore, regjistrat që lidhen me pasuritë që janë të zhvlerësueshme gjatë një periudhe prej më shumë se gjashtë (6) vjet, duhet të mbahen për jetëgjatësinë e zhvlerësueshme të pasurive, plus një vit shtesë.

E saktë

E pasaktë

9. Sipas Ligjit Për Administrimin e Procedurave Tatimore, kërkesa për kreditim ose rimbursim për një pagesë të tepërt të çfarëdo lloji të tatimit mund të dorëzohet brenda tre (3) vitesh nga data kur është paguar tatimi apo kur ka lindur e drejta e zbritjes

E saktë

E pasaktë

10. Sipas Ligjit Për Administrimin e Procedurave Tatimore, Administrata Tatimore e Kosovës ka të drejtë që pas vitit të dhjetë (10) nga vendosja e barrës sipas paragrafit 2 të këtij neni, të bëjë rivlerësimin e pasurisë me barrë tatimore dhe pasuria e cila vlerësohet që tërësisht apo pjesërisht mbulon detyrimin e pashlyer dhe e cila është konfiskuar në bazë të procedurave të mbledhjes së detyrueshme, kalon në pronë shtetërore

E saktë

E pasaktë

11. Sipas Ligjit Për Administrimin e Procedurave Tatimore, nëse një person i cili është i detyruar t'i paguajë ndonjë tatim ndaj ATK-së sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë shpërfill apo refuzon të paguajë atë tatim brenda dhjetë (10) ditëve pas dorëzimit të njoftim-vlerësimit, sikurse është paraparë me këtë ligji, do të lind një barrë në atë pasuri, apo të drejtat për pasurinë që i përket atij personi (qoftë e luajtshme apo e paluajtshme, e trupëzuar apo e patrupëzuar) në një shumë të barabartë me tatimin e papaguar, plus interesin, pagesën, ndëshkimet dhe shpenzimet e mbledhjes

E saktë

E pasaktë

12. Sipas Ligjit ne fuqi Për Tatimin ne te Ardhurat Personale, pensionet e paguara në përputhje me legjislacionin përkatës mbi Pensionet në Kosovë nga Trusti Pensionsal, janë te ardhura te liruar nga tatimi sipas këtij ligji.

E saktë

E pasaktë

13. Sipas Ligjit ne fuqi Për Tatimin ne te Ardhurat Personale , nuk lejohet zbritje për ndonjë shpenzim të akruar apo rrjedhur që lidhet me të ardhurat të cilat i nënshtrohen mbajtjes në burim, pagave, dividendëve, interesit, të drejtave pronësore, qirave, fitoreve në lotari, veç nëse janë paguar më apo para 31 marsit të periudhës tatimore vijuese.

E saktë

E pasaktë

14. Sipas ligjit ne fuqi Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave, Transferimi i pronës në pajtim me planin e shkruar për riorganizimin e tatimpaguesit qoftë për shkak të bankrotimit, bashkimit, përvetësimit, ndarjes, këmbimit të aksioneve, apo të ndonjë arsyeje tjetër, që e miraton ATK, nuk i nënshtrohet tatimeve sipas këtij ligji ne fuqi.

E saktë

E pasaktë

15. Sipas ligjit të TVSh-se, Autoritetet e nivelit qendror dhe lokal dhe organet tjera të rregulluara me ligj, duhet të konsiderohen si persona të tatueshëm në lidhje me aktivitetet ose transaksionet, në të cilat angazhohen si autoritete publike edhe atëherë kur mbledhin tagra, taksa, kontribute ose pagesa në lidhje me ato aktivitete ose me ato transaksione.

E saktë

E pasaktë

16. Sipas Ligjit të TVSH-së, shfrytëzimi i mallrave për biznes si mostra apo dhurata me vlerë të vogël, nuk të trajtohet si furnizim i mallrave për konsideratë

E saktë

E pasaktë

17. Sipas Ligjit Për Fondet Pensionale të Kosove, secila kompani e licencuar e sigurimeve ofron pensione vjetore dhe pjesëmarrësi, , është i lirë të zgjedhë njërin nga llojet e pensioneve vjetore si për shembull: pensionin e veçantë jetësor të garantuar për periudhën prej së paku pesë (5) vjet në bazë të të cilit, nëse pjesëmarrësi vdes gjatë periudhës së garancisë, shumat e papaguara që do t'i ishin paguar pjesëmarrësit për atë periudhë do t'iu paguhen përfituesve të caktuar nga pjesëmarrësi;

E saktë

E pasaktë

18. Sipas Ligjit Për Fondet Pensionale të Kosove, kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues janë personat që kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë (60) vjeçare.

E saktë

E pasaktë

19. Sipas Ligjit të Punës ne Kosovës, kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se pesë (5) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.

E saktë

E pasaktë

20. Sipas Ligjit të Punës ne Kosovës, punëdhënësi paraprak është i obliguar që në formë të shkruar t'i informojë të gjithë të punësuarit për bartjen e detyrimeve dhe përgjegjësi tek punëdhënësi i ardhshëm.

E saktë

E pasaktë

Pjesa C. Pyetjet problemore

Problemi 1

7 pikë

ABC Pharma SH.P.K gjatë muajit Maj 2024 regjistroi blerje të produkteve farmaceutike në shumën 30,000 Euro, përfshirë TVSH-në, dhe produkte jo-farmaceutike në shumën 15,000 Euro, përfshirë TVSH. Të gjitha këto produkte janë shitur po në këtë muaj. Shitja e produkteve farmaceutike sipas politikës së shitjes së kompanisë është realizuar me marzhën bruto 20%, ndërsa shitja e produkteve jo-farmaceutike me marzhën bruto 25%.

Nuk kishte stocë në fillim të muajit Maj 2024.

- Kërkohet:** a) Sa ishte vlera e TVSH-së e zbritshme në këtë muaj?
b) Sa ishte vlera e TVSH-së e llogaritur në këtë muaj?
c) Sa ishte vlera e TVSH-së e pagueshme në këtë muaj?

Zgjidhje

a) Vlera e TVSH-së e zbritshme në këtë muaj:

1. Produkte farmaceutike:

- Shuma përfshirë TVSH: 30,000 EUR
- Norma e TVSH: 8%

$$\text{Vlera pa TVSH} = 30,000 / 1 + 0.08 = 30,000 / 1.08 = 27,777.78$$

$$\text{TVSH e zbritshme për produktet farmaceutike} = 30,000 - 27,777.78 = 2,222.22 \text{ EUR}$$

2. Produkte jo-farmaceutike:

- Shuma përfshirë TVSH: 15,000 EUR
- Norma e TVSH: 18%

$$\text{Vlera pa TVSH} = 15,000 / 1 + 0.18 = 15,000 / 1.18 = 12,711.86$$

$$\text{TVSH e zbritshme për produktet jo-farmaceutike} = 15,000 - 12,711.86 = 2,288.14 \text{ EUR}$$

$$\text{Total TVSH e zbritshme} = 2,222.22 + 2,288.14 = 4,510.36 \text{ EUR}$$

b) Vlera e TVSH-së e llogaritur në këtë muaj:

1. Produkte farmaceutike:

- Vlera e shitjes = Vlera pa TVSH + Marzha

- Marzha bruto: 20%

Kostoja e shitjes pa TVSH = 27,777.78 EUR

Vlera e shitjes = $27,777.78 * (1 + 0.20) = 33,333.33$ EUR

TVSH e llogaritur për produktet farmaceutike = $33,333.33 * 8\% = 2,666.67$ EUR

2. **Produkte jo-farmaceutike:**

- Marzha bruto: 25%

Kostoja e shitjes pa TVSH = 12,711.86 EUR

Vlera e shitjes = $12,711.86 * (1 + 0.25) = 15,889.83$ EUR

TVSH e llogaritur për produktet jo-farmaceutike = $15,889.83 * 18\% = 2,860.17$ EUR

Total TVSH e llogaritur = $2,666.67 + 2,860.17 = 5,526.84$ EUR

c) **Vlera e TVSH-së e pagueshme në këtë muaj:**

TVSH e pagueshme = TVSH e llogaritur - TVSH e zbritshme

TVSH e pagueshme = $5,526.84 - 4,510.36 = 1,016.48$ EUR

Përmbledhje:

a) Vlera e TVSH-së e zbritshme në këtë muaj: 4,510.36 EUR

b) Vlera e TVSH-së e llogaritur në këtë muaj: 5,526.84 EUR

c) Vlera e TVSH-së e pagueshme në këtë muaj: 1,016.48 EUR

Problemi 2

10 pikë

Kompania ndërtimore Ndërtimi Sh.A ka filluar projektin me ndërtim të larte që do të zgjat tre (3) vite. Bazuar në përlllogaritjet fillestare kompania planifikon të ardhura në tërësi nga projekti 8,000,000 euro (1,000 eur për m²) dhe një kosto e tërësishme 6,000,000 euro. Ndërtesa përmbana 8,000 m² për shitje.

Viti i III- Kompania realizoj inkasimin e keshit nga marrëveshjet e shitjeve në vlere prej 800,000 000 Eur.

Ky vite është përfundimi i projektit dhe është bere pranimi teknik në fillim të Dhjetorit. Në fund të viti kjo është gjendja e kompanisë:

Llogari të arktushme 5,000,000 EUR.

Informacion shtese:

Gjatë tre viteve është realizuar e ter shitja që në total është e 9,000,000 Euro, ndërsa kostoja e tërësishëm në funde të projektit rezultojë të jete 6,500,000 Euro.

Kërkohet:

- Sa është diferenca e KMSH që duhet rregulluar për dy vitet e para?
- Sa është e ardhura e tatueshme dhe KMSH për vitin e III ?
- Sa është detyrimi tatimore për këtë vit?

Zgjidhje

a) Diferenca e KMSH që duhet rregulluar për dy vitet e para

Në dy vitet e para, të ardhurat e njohura sipas keshit ishin 3,200,000 EUR, me një koeficient për KMSH prej 0.40. Kjo do të thotë se KMSH për dy vitet e para ishte:

$$\text{KMSH} = 6,000,000 \times 0.40 = 2,400,000 \text{ EUR}$$

Në fund të projektit, kostoja totale rezultoi të jetë 6,500,000 EUR. Koeficienti për KMSH për dy vitet e para është:

$$500,000 \times 0.40 = 200,000 \text{ EUR}$$

Pra, diferenca e KMSH që duhet rregulluar për dy vitet e para është 200,000 EUR.

b) E ardhura e tatueshme dhe KMSH për vitin e III

Në vitin e tretë, e gjithë ndërtesa është shitur dhe të ardhurat e njohura janë 800,000 EUR nga kesh dhe 5,000,000 EUR nga llogaritë e arktueshme. Totali është:

$$800,000 + 5,000,000 = 5,800,000 \text{ EUR}$$

Koeficienti për KMSH për vitin e tretë është:

$$6,500,000 \times 0.60 = 3,900,000 \text{ EUR}$$

Pra, KMSH për vitin e tretë është 3,900,000 EUR.

c) Detyrimi tatimor për këtë vit

Fitimi bruto për vitin e tretë do të llogaritet duke zbritur KMSH e vitit të tretë dhe diferencën e KMSH për dy vitet e para.

Fitimi bruto për vitin e tretë:

$$\text{Fitimi bruto} = 5,800,000 - 3,900,000 - 200,000 = 1,700,000 \text{ EUR}$$

$$\text{Tatimi mbi fitimin} = 1,700,000 \times 0.10 = 170,000 \text{ EUR}$$

Përmbledhje:

- a) Diferenca e KMSH që duhet rregulluar për dy vitet e para: 200,000 EUR
- b) E ardhura e tatueshme për vitin e III: 5,800,000 EUR dhe KMSH: 3,900,000 EUR
- c) Detyrimi tatimor për këtë vit: 170,000 EUR

Kompania "MarketSolutions "B.I me seli në Prishtinë ka prezantuar informatat e saj për aktivitetin afarist gjatë 12 mujorit të vitit të kaluar 2023. Disa nga të dhënat janë si vijon:

- i. Importe të rregullta mall tregtar: 150,000 Euro (përfshirë TVSH 18%)
- j. Avancet e pranuar nga klientët: 30,000 Euro (saldo me datë 31 dhjetor)
- k. Export në Shqipëri: 45,000 Euro
- l. Shitjet kesh për klientë të rastit: 180,000 Euro (përfshirë TVSH 18%)
- m. Shitjet me afat për biznese: 100,000 Euro (përfshirë TVSH 8%)
- n. Shpenzimet administrative: 6,000 Euro
- o. Pagat Bruto: 35,000 Euro (përfshirë KP të punëdhënësit)
- p. Shpenzime të mirëmbajtjes: 5,000 Euro (përfshirë TVSH 8%)
- q. Blerjet vendore (materiale zyre): 25,000 Euro (përfshirë TVSH 18%)
- r. Provizionit për llogaritë e arkëtushme: 4,000 Euro
- s. Import investiv (pajisje): 25,000 Euro (përfshirë TVSH 18%)
- t. Shpenzimet e zhvlerësimit vjetor: 12,000 Euro
- u. Stoqet në fillim të vitit: 60,000 Euro (me kosto)
- v. Shpenzime për promovimin dhe marketingun: 5,000 Euro (përfshirë TVSH 18%)
- w. Stoqet në fund të vitit: 65,000 Euro (me kosto)
- x. Shpenzimet për konsulencë: 30,000 Euro (përfshirë TVSH 18%)
- y. Shpenzimet për transportin dhe logjistikën: 6,000 Euro (pa TVSH)
- z. Tërheqjet nga pronari: 12,000 Euro (kesh)

Kërkesat:

- a) Përpiloni deklaratën vjetore (ekstrakt) sipas ligjit TAP për kompaninë "MarketSolutions " B.I.
- b) Llogaritni të ardhurat e tatueshme dhe KMSH për vitin 2023.
- c) Llogaritni tatimin në fitim për vitin 2023.

Zgjidhja:

a) Përpilimi i Deklaratës Vjetore (Ekstrakt) me rregullimet

Të ardhurat:

1. **Shitjet kesh për klientë të rastit:**
 - Totali (përfshirë TVSH 18%): 180,000 EUR
 - Pa TVSH: $180,000/1.18=152,542.37$ EUR
2. **Shitjet me afat për biznese:**
 - Totali (përfshirë TVSH 8%): 100,000 EUR
 - Pa TVSH: $100,000/1.08=92,592.59$ EUR
3. **Export në Shqipëri (pa TVSH):** 45,000 EUR

Total të ardhura pa TVSH:

$152,542.37+92,592.59+45,000=290,134.96$ EUR

Shpenzimet:

1. **Importe të rregullta mall tregtar (pa TVSH):**
 - Totali (përfshirë TVSH 18%): 150,000 EUR
 - Pa TVSH: $150,000/1.18=127,118.64$
2. **Shpenzimet administrative:** 6,000 EUR (pa TVSH)
3. **Pagat Bruto:** 35,000 EUR
4. **Shpenzime të mirëmbajtjes:**
 - Totali (përfshirë TVSH 8%): 5,000 EUR
 - Pa TVSH: $5,000/1.08=4,629.63$
5. **Blerjet vendore (materiale zyre):**
 - Totali (përfshirë TVSH 18%): 25,000 EUR
 - Pa TVSH: $25,000/1.18=21,186.44$ EUR
6. **Shpenzimet për promovimin dhe marketingun:**
 - Totali (përfshirë TVSH 18%): 5,000 EUR
 - Pa TVSH: $5,000/1.18=4,237.29$ EUR
7. **Shpenzimet për konsulencë:**
 - Totali (përfshirë TVSH 18%): 30,000 EUR
 - Pa TVSH: $30,000/1.18=25,423.73$ EUR
8. **Shpenzimet për transportin dhe logjistikën:** 6,000 EUR (pa TVSH)
9. **Shpenzimet e zhvlerësimit vjetor:** 12,000 EUR
10. **Provizioni për llogaritë e arkëtushme:** 4,000 EUR (nuk pranohet si shpenzim për qëllime tatimore)

Llogaritja e KMSH-së:

$KMSH = \text{Stoqet në fillim} + \text{Blerjet} - \text{Stoqet në fund}$

- Stoqet në fillim: 60,000 EUR
- Blerjet (Importe të rregullta mall tregtar pa TVSH): 127,118.64 EUR
- Stoqet në fund: 65,000 EUR

$KMSH = 60,000 + 127,118.64 - 65,000 = 122,118.64 \text{ EUR}$

Total shpenzime pa TVSH:

$SHPZ = 122,118.64 + 6,000 + 35,000 + 4,629.63 + 21,186.44 + 4,237.29 + 25,423.73 + 6,000 + 12,000 = 236,595.73 \text{ EUR}$

b) Llogaritja e të ardhurave të tatueshme dhe KMSH për vitin 2023

Të ardhurat e tatueshme:

Te ardhurat 290,134.96

SHPP (236,597.73)

Fitimi i tatueshem 53,539.23

c) Llogaritja e tatimit në fitim për vitin 2023

Shkalla tatimore:

- Nga 0-960 EUR: 0%
- Nga 960-3,000 EUR: 4%
- Nga 3,000-5,400 EUR: 8%
- Mbi 5,400 EUR: 10%

Tatimi mbi të ardhurat:

1. $960 \times 0\% = 0 \text{ EUR}$
2. $2,040 \times 4\% = 81.60 \text{ EUR}$
3. $2,400 \times 8\% = 192 \text{ EUR}$
4. $48,139.23 \times 10\% = 4,813.92 \text{ EUR}$

Tatimi total mbi të ardhurat:

$0 + 81.60 + 192 + 4,813.92 = 5,087.52 \text{ EUR}$

b) Të ardhurat e tatueshme: 53,539.23 EUR

c) Tatimi në fitim për vitin 2023: 5,087.52 EUR

Problemi 4

15 pikë

Kompania "InnovateTech SH.P.K", me seli në Prishtinë, operon në sektorin e teknologjisë dhe inovacionit në tërë territorin e Kosovës. Gjatë muajit Qershor 2024, kompania ka kryer transaksionet e mëposhtme ekonomike:

- i. Shitjet brenda vendit me normë standarde - shuma e tatueshme 30,000 Euro;
- ii. Shitjet brenda vendit me normë të reduktuar - shuma e tatueshme 8,000 Euro;
- iii. Shitje të përjashtuara pa të drejtë kreditimi - 5,000 Euro;
- iv. Shpenzime për shërbime ligjore të pranuar nga kompania jashtë vendit - 2,000 Euro;
- v. Import i pajisjeve harduerike - në vlerë 15,000 Euro;
- vi. Blerje i pajisjeve softuerike për zyrë - në vlerë 50,000 Euro;
- vii. Import i një automjeti për qëllime operative - në vlerë 40,000 Euro;
- viii. Blerje nga subjekte jo të tatueshme - në vlerë 3,000 Euro;
- ix. Shpenzime për takime biznesi - në vlerë 1,200 Euro me norme standarde;
- x. Shpenzime administrative për aktivitetin ekonomik me normë standarde - 1,000 Euro;
- xi. Shpenzime administrative për aktivitetin ekonomik me normë të reduktuar - 600 Euro;
- xii. Notë kreditore e lëshuar me normë standarde - vlera 800 Euro shuma e tatueshme;
- xiii. Notë kreditore e pranuar me normë standarde - vlera 900 Euro shuma e tatueshme;
- xiv. Fatura e borxhit të keq e lëshuar me normën standarde - vlera 600 Euro.

Vlerat e paraqitura janë pa përfshirë TVSH-në. Koeficienti për vitin 2024 është 85% dhe do të shfrytëzohet për këtë muaj.

Kërkesa:

Përpiloni ekstraktin e deklaratës së TVSH-së për "InnovateTech SH.P.K" për muajin Qershor 2024, duke treguar sa ka pagesë/kreditim. Përfshini llogaritjet e hollësishme të TVSH-së të llogaritur dhe të zbritshme, duke aplikuar normat përkatëse dhe koeficientin e përmendur.

Zgjidhja:

Periudha e Deklarimit:

Numri fiskal

Emri I biznesit

InovateTesh SH.P.K

Emri I personit kontaktues

		Furnizimet		
Shitjet e liruara pa te drejtë kreditimi	[9]	5,000		
Shitjet e liruara me drejtë kreditimi	[10]			
Eksportet	[11]			TVSH e llog
Shitjet e tatushme me normën 18%	[12]	30,000	[13]	5,400
Shitjet e tatushme me normën 8%	[14]	8,000	[15]	640
Nota debitore e leshuar,nota kreditore e pranuar me normë 18%	[16]	765	[17]	138
Nota debitore e leshuar,nota kreditore e pranuar me norme 8%	[18]		[19]	-
Fatura e borxhit te keq e pranuar, inkasimi I B.K me normë 18%	[20]		[21]	-
Fatura e borxhit te keq e pranuar, inkasimi I B.K me normë 8%	[22]		[23]	-
Rregulimet per te rritur TVSH-në me normë 18%	[24]		[25]	-
Rregulimet per te rritur TVSH-në me normë 8%	[26]		[27]	-
Blerjet qe I nënshtrohen ngarkesës së kundërt	[28]	2,000	[29]	360
			[30]	6,538
		Blerjet		Totali i TVSH së llog
Blerjet dhe importet pa TVSH	[30]	3,000		
Blerjet dhe importet investive pa TVSH	[31]	15,000		
Blerjet dhe importet meTVSH jo te zbritshme	[33]	16,287		
Blerjet dhe importet investive meTVSH jo te zbritshme	[34]	23,600		
Importet me normë 18%	[35]		[36]	-
Importet me normë 8%	[37]		[38]	-
Importet investive me normë 18%	[39]	17,000	[40]	3,060
Importet investive me normë 8%	[41]		[42]	-
Blerjet vendore me normë 18%	[43]	850	[44]	153
Blerjet vendore me normë 8%	[45]	510	[46]	41
Blerjet investive vendore me normë 18%	[47]	42,500	[48]	7,650
Blerjet investive vendore me normë 8%	[49]		[50]	-
Blerjet nga feremrët vendore me normë 8%	[51]		[52]	-
Nota debitore e pranuar, nota kreditore e lëshuar me normë 18%	[53]	800	[54]	144
Nota debitore e pranuar, nota kreditore e lëshuar me normë 8%	[55]		[56]	-
Fatura e borxhit te keq e lëshuar, pagesa e borxhit të keq me normë 18%	[57]	600	[58]	108
Fatura e borxhit te keq e lëshuar, pagesa e borxhit të keq me normë 8%	[59]		[60]	-
Rregullimet për te ulur TVSH-në me normë 18%	[61]		[62]	-
Rregullimet për te ulur TVSH-në me normë 8%	[63]		[64]	-
E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me ngarkesën e kundërt me normë 18%	[65]	1,700	[66]	306
			[67]	11,462
		Kalkulimi		Totali i TVSH së

Teprica e TVSH-së e bartur nga muaji I kaluar	[68]	
Balanca kreditore e mbetur $69=((67+68)-30)>0$	[69]	
Kërkesa për rimbursim	[70]	
Kreditimi I tvsh-së për muajin pasues $71=(69-70)$	[71]	
TVSH që duhet te paguhet $72=(30-67-68)>0$	[72]	(4,924)

	Vlerat totale		1	TVSH 85%	Blerje 15%	TVSH e 15%	TOTALjo e zbritshem 24)
39)	20,000	3,600	17,000	3,060	3,000	540	
43)	1,000	180	850	153	150	27	
46)	600	48	510	41	90	7	
47)	50,000	9,000	42,500	7,650	7,500	1,350	
53)	800	144	680	122	800	144	
57)	600	108	510	92	600	108	
65)	2,000	1,700	1,700	1,445	300	255	
Shpenzim					1,200	216	
					13,640	2,647	16,287

Të dhënat bazë dhe llogaritjet e TVSH-së:

Shitjet:

- Shitjet brenda vendit me normë standarde (18%):**
 - Shuma e tatueshme: 30,000 EUR
 - TVSH e llogaritur: $30,000 \times 0.18 = 5,400$ EUR
- Shitjet brenda vendit me normë të reduktuar (8%):**
 - Shuma e tatueshme: 8,000 EUR
 - TVSH e llogaritur: $8,000 \times 0.08 = 640$ EUR
- Shitjet të përjashtuara pa të drejtë kreditimi: 5,000 EUR**

4. **Nota kreditore e pranuar me normë standarde (18%):**
 - Shuma e tatueshme: 900 EUR
 - TVSH e llogaritur: $900 \times 0.18 = 162 \times 85\% = 138$
5. **Shpenzime për shërbime ligjore të pranuar nga kompania jashtë vendit:**
 - Shuma: 2,000 EUR (ngarkesë e kundërt, normë standarde)
 - TVSH e zbritshme: $2,000 \times 0.18 = 360$ EUR

Blerjet:

1. **Shpenzime për shërbime ligjore të pranuar nga kompania jashtë vendit:**
 - Shuma: 2,000 EUR (ngarkesë e kundërt, normë standarde)
 - TVSH e zbritshme: $2,000 \times 0.18 = 360 \times 85\%$ EUR
2. **Import i pajisjeve harduerike:**
 - Shuma: 15,000 EUR
3. **Blerje i pajisjeve softuerike për zyrë:**
 - Shuma: 50,000 EUR (normë standarde)
 - TVSH e zbritshme: $50,000 \times 0.18 = 9,000 \times 85\%$
4. **Import i një automjeti për qëllime operative:**
 - Shuma: 40,000 EUR (normë standarde vetëm 50%)
 - TVSH: $20,000 \times 0.18 = 3,600 \times 85\%$
5. **Blerje nga subjekte jo të tatueshme: 3,000 EUR (pa TVSH)**
6. **Shpenzime për takime biznesi:**
 - Shuma: 1,200 EUR (normë standarde)
7. **Shpenzime administrative për aktivitetin ekonomik me normë standarde:**
 - Shuma: 1,000 EUR
 - TVSH e zbritshme: $1,000 \times 0.18 = 180 \times 85\%$ EUR
8. **Shpenzime administrative për aktivitetin ekonomik me normë të reduktuar:**
 - Shuma: 600 EUR
 - TVSH e zbritshme: $600 \times 0.08 = 48 \times 85\%$ EUR
9. **Nota kreditore e lëshuar me normë standarde (18%):**
 - Shuma e tatueshme: 800 EUR
 - TVSH e llogaritur: $800 \times 0.18 = 144$ EUR (e ulur nga shitjet)
10. **Fatura e borxhit të keq e lëshuar me normën standarde (18%):**
 - Shuma e tatueshme: 600 EUR
 - TVSH e llogaritur: $600 \times 0.18 = 108$ EUR (e ulur nga shitjet)

Kompania "Qershia Sh.p.k", e themeluar në vitin 2022, operon në sektorin e teknologjisë në qytetin e Prishtinës. Më datën 31 Dhjetor 2023, kompania kishte gjendjen e shpenzimeve të zhvlerësimit në pasqyrat financiare sipas politikave kontabël si vijon:

- **Grupi I:**
 - Zyrat Qendrore: 5,000 Euro
- **Grupi II:**
 - Furgoni për Transport: 1,000 Euro
 - Ekskavatori: 2,000 Euro
- **Grupi III:**
 - Printerë Industrialë: 4,000 Euro
 - Robotët e Asamblimit: 3,000 Euro

Informacioni shtese:

Politika kontabël e zhvlerësimit kishte këto shkalle zhvlerësimi: Grupi I 4%; Grupi II 15% dhe Grupi trete 12%

Kërkohe:

- a. Llogaritni zhvlerësimin tatimor për secilin aset.
- b. Llogaritni diferencën e shpenzimeve të zhvlerësimit sipas politikave kontabël dhe ligjit tatimor.
- c. Sa është rritja apo zvogëlimi i tatimit në këtë ndryshim

Zgjidhje

a. Llogaritja e zhvlerësimit tatimor për secilin aset

Grupi I: Zyrat Qendrore (Norma kontabël 4%, norma tatimore 5%)

- Shpenzimet e zhvlerësimit kontabël: 5,000 EUR
- Vlera e asetit: $5,000 / 0.04 = 125,000$ EUR
- Zhvlerësimi tatimor: $125,000 \times 0.05 = 6,250$ EUR

Grupi II: Furgoni për Transport dhe Ekskavatori (Norma kontabël 15%, norma tatimore 20%)

1. Furgoni për Transport:
 - Shpenzimet e zhvlerësimit kontabël: 1,000 EUR
 - Vlera e asetit: $1,000 / 0.15 = 6,667$ EUR
 - Zhvlerësimi tatimor: $6,667 \times 0.20 = 1,333.40$
2. Ekskavatori:
 - Shpenzimet e zhvlerësimit kontabël: 2,000 EUR

- Vlera e asetit: $2,0000/15=13,333$ EUR
- Zhvlerësimi tatimor: $13,333 \times 0.20=2,666.60$ EUR

Grupi III: Printerë Industrialë dhe Robotët e Asamblimit (Norma kontabël 12%, norma tatimore 10%)

1. Printerë Industrialë:
 - Shpenzimet e zhvlerësimit kontabël: 4,000 EUR
 - Vlera e asetit: $4,0000/12=33,333$ EUR
 - Zhvlerësimi tatimor: $33,333 \times 0.10=3,333.30$ EUR
2. Robotët e Asamblimit:
 - Shpenzimet e zhvlerësimit kontabël: 3,000 EUR
 - Vlera e asetit: $3,0000/12=25,000$ EUR
 - Zhvlerësimi tatimor: $25,000 \times 0.10=2,500$
 -

b. Diferenca e shpenzimeve të zhvlerësimit sipas politikave kontabël dhe ligjit tatimor

Grupi I: Zyrat Qendrore

- Zhvlerësimi kontabël: 5,000 EUR
- Zhvlerësimi tatimor: 6,250 EUR
- Diferenca: $6,250-5,000=1,250$ EUR (më shumë zhvlerësim tatimor)

Grupi II: Furgoni për Transport dhe Ekskavatori

1. Furgoni për Transport:
 - Zhvlerësimi kontabël: 1,000 EUR
 - Zhvlerësimi tatimor: 1,333.40 EUR
 - Diferenca: $1,333.40-1,000=333.40$ EUR (më shumë zhvlerësim tatimor)
2. Ekskavatori:
 - Zhvlerësimi kontabël: 2,000 EUR
 - Zhvlerësimi tatimor: 2,666.60 EUR
 - Diferenca: $2,666.60-2,000=666.60$ EUR (më shumë zhvlerësim tatimor)

Grupi III: Printerë Industrialë dhe Robotët e Asamblimit

1. Printerë Industrialë:
 - Zhvlerësimi kontabël: 4,000 EUR
 - Zhvlerësimi tatimor: 3,333.30 EUR
 - Diferenca: $4,000-3,333.30=666.70$ EUR (më pak zhvlerësim tatimor)
2. Robotët e Asamblimit:
 - Zhvlerësimi kontabël: 3,000 EUR
 - Zhvlerësimi tatimor: 2,500 EUR
 - Diferenca: $3,000-2,500=500$ EUR (më pak zhvlerësim tatimor)

c. Sa është rritja apo zvogëlimi i tatimit në këtë ndryshim

Totali i ndryshimeve:

- Diferenca për Zytrat Qendrore: +1,250 EUR
- Diferenca për Furgonin për Transport: +333.40 EUR
- Diferenca për Ekskavatorin: +666.60 EUR
- Diferenca për Printerët Industrialë: -666.70 EUR
- Diferenca për Robotët e Asamblimit: -500 EUR

Totali: $1,250+333.40+666.60-666.70-500=1,083.30$ EUR

Kjo do të thotë që ka një rritje neto në shpenzimet e zhvlerësimit tatimor prej 1,083.30 EUR. Kjo rritje në shpenzimet e zhvlerësimit do të rezultojë në një zvogëlim të të ardhurave të tatueshme dhe për rrjedhojë një zvogëlim të tatimit të pagueshëm.

Llogaritja e ndikimit në tatimin mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin është 10%. Pra, zvogëlimi i tatimit është:

$1,083.30 \times 0.10 = 108.33$ EUR

Kompania "Treni Sh.p.k" kishte dy të punësuar primar gjatë tërë vitit 2023.

- I punësuar në rolin e menaxherit krijoi të ardhura neto nga kompania në vlerë prej 12,000 euro.
- I punësuar i dytë në rolin e inxhinierit krijoi të ardhura bruto nga kjo kompani në vlerë prej 14,000 euro.

Kërkohet:

- Sa ishte tatimi në të ardhura personale për dy të punësuarit që kompania ndali në burim?
- Sa ishin kontributet pensionale për dy të punësuarit duke përfshirë edhe kontributin e punëdhënësit sipas ligjit mbi pensionet në Kosovë?

Zgjidhje

a. Llogaritja e Tatimit në të Ardhura Personale

a.1). Punësuar 1: Menaxher

1. **Të ardhurat neto:** 12,000 EUR

Për të llogaritur pagën e tatueshme (bruto) nga paga neto, duhet të shtojmë tatimin mbi të ardhurat:

Paga neto = Paga e tatueshme - Tatimi mbi të ardhurat

12,000 = Paga e tatueshme - Tatimi mbi të ardhurat

12,000 = Paga e tatueshme - (81.60 + 192 + (Paga e tatueshme - 5,400) × 0.10)

12,000 = Paga e tatueshme - 273.60 - 0.10 × Paga e tatueshme + 540

12,000 = 0.90 × Paga e tatueshme + 266.40

12,000 - 266.40 = 0.90 × Paga e tatueshme

11,733.60 = 0.90 × Paga e tatueshme

Paga e tatueshme = 11,733.60 / 0.90 = 13,037.33

Tatimi mbi të ardhurat llogaritet sipas shkallëve tatimore:

1. **Tatimi për intervalin 0 - 960 EUR:**
 - Tatimi: $960 \times 0\% = 0$ EUR
2. **Tatimi për intervalin 960 - 3,000 EUR:**
 - Tatimi: $(3,000 - 960) \times 4\% = 2,040 \times 0.04 = 81.60$
3. **Tatimi për intervalin 3,000 - 5,400 EUR:**
 - Tatimi: $(5,400 - 3,000) \times 8\% = 2,400 \times 0.08 = 192$
4. **Tatimi për të ardhurat mbi 5,400 -11,037.33 EUR:**
 - Tatimi: $(13,037.33 - 5400) \times 10\% = 7,637.33 \times 0.10 = 763.73$

Total tatimi mbi të ardhurat: $0 + 81.60 + 192 + 763.73 = 1,037.33$ EUR

Përmbledhje e të ardhurave për Menaxherin:

- **Të ardhurat neto:** 12,000 EUR
- **Tatimi mbi të ardhurat:** 1,037.33 EUR

a.2). Punësuari 2: Inxhinier

- Të ardhurat bruto: **14,000 EUR**
- Kontributet pensionale (5%): $14,000 \times 0.05 = 700$
- Të ardhurat e tatueshme: $14,000 - 700 = 13,300$

Llogaritja e Tatimit mbi të Ardhurat Personale:

- Tatimi: $960 \times 0\% = 0$ EUR
- Tatimi: $(3,000 - 960) \times 4\% = 2,040 \times 0.04 = 81.60$
- Tatimi: $(5,400 - 3,000) \times 8\% = 2,400 \times 0.08 = 192$
- Tatimi: $(13,300 - 5400) \times 10\% = 7,900 \times 0.10 = 790$

Total tatimi mbi të ardhurat: $0 + 81.60 + 192 + 790 = 1,063.60$ EUR

b). Kontributet Pensionale:

b.1. Punësuari 1: Menaxher

Paga bruto = Paga e tatueshme / 0.95 = $13,037.33 / 0.95 = 13,273.51$

- Kontributi i punëdhënësit $13,273.51 \times 5\% = 686.18$
- Kontributi i punësuarit $13,273.51 \times 5\% = 686.18$

b.2. Punësuari 2: Inxhinier

Paga bruto = 14,000

- Kontributi i punëdhënësit $14,000 \times 5\% = 700$
- Kontributi i punësuarit $14,000 \times 5\% = 700$

Përmbledhje e detyrës:

a) Tatimi mbi të ardhurat personale për dy të punësuarit:

- Menaxheri: 1,037.33 EUR
- Inxhinieri: 1,063.60 EUR
- **TOTAL 2,100.93 EUR**

b) Kontributet pensionale për dy të punësuarit:

- Menaxheri: 1,372.36 EUR
- Inxhinieri: 1,400.00 EUR
- **TOTAL 2,772.36 EUR**